



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr.07/351/01-11366

Dt.05.06.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit duke vendosur sipas kërkesës së parashtruar nga: **Ruzhdi Bokshi nga Gjakova, në cilësinë e pronarit të N.T.P."WEAR & Go", me seli në Gjakovë, dhe me numër të biznesit 80103999**, për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt ekonomik për prodhim – rrobaqepësi, me etazhitet 2B+P+2 në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, si dhe Ligjit për Procedurën Administrative Nr 02/L-28 nenit 11, bien këtë:

AKTVENDIM

I. I LEJOHET: N.T.P."WEAR & Go", me seli në Gjakovë, me numër të biznesit 80103999, dhe me pronar Ruzhdi Bokshi nga Gjakova, ndërtimi i Objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt ekonomik për prodhim – rrobaqepësi, sipas Projektit Kryesor të prezantuar, në përputhshmëri me Planin Zhvillimor Urban dhe Vendimin për Kushte Ndërtimore, me nr.07-351/01-3857, dt.28.03.2017 të lëshuar nga DUMM, në ngastrën kadastrale me nr. 5545/8, ZK: Gjakovë -J- Qytet, në pronësi të "N.T.P."Wear & Go", në rrugën "Gaspër Karaqi", e cila ka vijën e ndërtimit dhe rregullimit të definuar dhe të prezantuar në planin e situacionit me të gjithë parametrat tjerë përcjellës për ndërtimin e objektit në fjalë, etazhiteti i objektit është 2B+P+2, në sipërfaqe të përgjithshme (bruto) të objektit prej **S=1560.35 m²**

Bodrumi 2 (niveli -5.60): (Sip,Bruto): S=335.00 m²

Bodrumi 1 (niveli -2.80): (Sip,Bruto): S=136.50 m²

Përdhesa: (Sip,Bruto): S=353.10 m²

Kati i parë: (Sip,Bruto): S=365.00 m²

Kati i dytë: (Sip,Bruto): S=370.75 m²

I. Hartimin e projektit me destinim: ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë, me destinim - objekt ekonomik (depo e materialit sanitar), me destinim – objekt ekonomik për prodhim – rrobaqepësi nga pika 1 e këtij aktvendimi e ka bërë ndërmarrja për projektim, ndërtim, inxhiniering "POINT DD". - Gjakovë.

II. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është Plan Situacioni i lokacionit me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, e përshkruar në situacionin grafik për të cilin është dhënë pëlqimi përkatës nga kjo drejtori i cili është bazë për rilevimin gjeodezik të objektit nga pika 1 e këtij aktvendimi.

III. Investitori është i obliguar:

- Që të ruaj një ekzemplar origjinal të dokumentacionit teknik në bazë të cilit i është dhënë kjo Leje Ndërtimi;
- Që pa pëlqimin e hartuesit të projektit kryesor dhe pëlqimin e kësaj Drejtorie, të mos bëjë asnjë ndryshim në projekt;
- Ekzekutimi i punimeve nga pika 1 e këtij Aktvendimi, të realizohet nën mbikëqyrjen e organit mbikëqyrës për realizimin e ndërtimit të objektit.
- Të lajmëroj Drejtorinë e inspektionit për ditën e fillimit të punës së paku 8(tetë) ditë para fillimit të ndërtimit, me qëllim të verifikimit dhe përcjelljes së punimeve:

VI. Kjo Leje Ndërtimi vlen 1(një) vit nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi.

Arsyetim

Ruzhdi Bokshi nga Gjakova, në cilësinë e pronarit të N.T.P."WEAR & Go", me seli në Gjakovë, në rrugën "Gaspër Karaqi" dhe me numër të biznesit 80103999 ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr. 07/351/01-11366, dt.08.05.2017, për dhënien e Lejes së Ndërtimit, për ndërtimin e objektit të kategorisë së dytë, me destinim – objekt ekonomik për prodhim – rrobaqepësi, me etazhitet 2B+P+2, në ngastrën kadastrale me nr. 5545/8, ZK: Gjakovë -J- Qytet, në pronësi të "N.T.P."Wear & Go", në rrugën "Gaspër Karaqi", siq është përshkruar në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Së bashku me kërkesën investitori e ka prezantuar edhe këtë dokumentacion:

1. Planin e Situacionit në përpjesë 1:1 000 , të datës 28.03.2017, i vërtetuar nga DUMM-Gjakovë.
2. Kopjen e planit të datës 21.02.2017, në pronësi të NTP"Wear & Go" të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
3. Çertifikatën mbi të drejtën në pronën e paluajtshme(fotokopje) me nr.të lëndës 239/17 të datës 21.02.2017, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
4. Certifikatën mbi Regjistrimin e biznesit, nga Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë, R.Kosovës.
5. Deklaratën Noteriale mbi lejin e ndërtimit në kufi të parcelës, nga fqinjët.
6. Vendimin për Kushte Ndërtimore për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit ekonomik. në ngastrën kadastrale me nr. 5545/8, ZK: Gjakovë-J-Qytet, të datës 28.03.2017.
7. Raporti mbi kërkimet gjeomekanike në teren si dhe kërkimet laboratorike në lokacionin e parashikuar për ndërtimin e objektit afarist, me Investitor NNP"Wear & Go" Gjakove, në ngastrën kadastrale me nr.5545/8, të hartuar nga "GEOtest Engineering_Roahovec.
8. Pëlqimin Sanitar, me nr 14/530/01-6941, të datës 05.05.2017, nga Inspektoriati Sanitar komunal-Drejtoria për Punë Inspektuese.
9. Pëlqimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, me nr.08-320/01-4515, dt.02.03.2017, nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
10. Pëlqimin për lokacion nga mbrojtje kundër zjarrit, me nr.02/17, me datë 02.02.2017, lëshuar nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent, Ministria e Punëve të Brendshme e R.K.S.
11. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, nr 430-B-243 të datës 13.02.2017.
12. Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë, dt. 15.11.2017.
13. Pëlqimin nga K.R.U."Radoniqi"Sh.A.-Gjakovë, nr. të datës 25.07.2017.
14. Pëlqimin nga PTK-Sh.A. Gjakovë, të datës 25.07.2017.
15. Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në Pro Credit Bank, filjala në Gjakovë, të datës 02.06.2017.
16. Projektin kryesor në 3 (tri) kopje, i punuar nga ndërmarrja për projektim, ndërtim, inxhiniering "POINT DD". - Gjakovë.

Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 4010.10 Euro.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Aktvendimi i dorëzohet:

- Investitorit,
- Drejtorisë së Inspekcionit ,
- Arhivës.

Zyrtar i lartë për çështje juridike

Zenel Shabani, jur.dipl.

U.D. Drejtori

Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.


Kuvendi Komunës GJAKOVË
Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë

KOPJE PLANI

Zona kad. Gjakovë-Jasht-Qytet

Shk. zvog. 1: 2500

Poseduesi: N.T.P"WEAR&GO"
nga Gjakova



Numri rendor i regjistrimit të taksave kadastrale: _____

Nr. Parcelës	Plani	Vendi i quajtur	Kultura	Klasa	Sipërfaqja			Vërejtjet
					Ha	a	m ²	
5545/7		Nakarade	Arë	4	0	12	56	
			Ndertes		0	02	94	
5545/8		Nakarade	Arë	4	0	08	76	
5545/9		Nakarade	Arë	4	0	01	42	
5545/10		Nakarade	Arë	4	0	06	87	
			Gjithësejta		0	32	55	

Që kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në kadastrë duke paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

Gjakovë 21.02. të vitit 2017

VËRTETON:


K.K. GJAKOVË

Kom. kad:Gj-J-Q

Parc.nr.5545 /7,8,9,40

PLAN SITUACIONI

Lokacioni i aprovuar nga DUMM për ngastrën
nr.5545/8



Gjendja kadastrale
Gjendja faktike

Sipërfaqja e gabaritit të
përdhësës
S= 353.51m²

Gjakovë;
28.03.2017

Vërteton urbaniste:
Mirlinda Mullahasani,
inxh.dip.ark.

P = 1 : 1 000